
	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

Datë/a:	05.06.2020
Për/ Za/ To:	“Dino SHPK”
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të datës 02.06.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Dino SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Tregu i ri i qytetit**, me Numër të Prokurimit: **616 19 9686 511** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga “Dino SHPK” e dates 02.06.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Tregu i ri i qytetit”, me Nr. të Prok: **616 19 9686 511**, kundër Vendimit të AK -së, të datës **28.05.2020**.

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit me titull “Tregu i ri i qytetit”, me Nr. të Prok: **616 19 9686 511** “ta vazhdoj sipas Njoftimit të dates **28.05.2020**.”

4. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 03.06.2020 ka shqyrtuar kërkesën e grupit të OE-ik “Dino SHPK” dhe lidhur me pretendimet e të njejtit ka konstatuar si vijon:
 -Pretendimi i parë është pjeserisht i bazuar pasi që duke analizuar dëshmitë e dorëzuara për stafin kam konstatuar se pervoja e nje inxhinieri (inxh.i elektros)nuk eshte aqe sa eshte kerkuar,mirepo edhe gjate vleresimit e edhe tani komisioni profesional ka konstauar se ajo paraqet devijim te vogel dhe se i njehti ploteson kriterin tjeter-deshmite e menaxhimit te se


paku dy kontratave te ngjajshme. Per kete eshte konstauar se ky konzorcium e ploteson kerkesen e Autoritetit Kontraktues;

-Poashtu është i sakte pretendimi juaj lidhur me skadimin e regjistrimit të dy kamionëve, mirepo ju sqarojme se ne kerkesat e FDT-se nuk eshte cekur se duhet te dorezohen libreza valide te regjistrimit dhe per kete jane trajtuar si dokumente te pranueshme.

Bazuar në sqarimet paraprake u vendos si në dispozitiv të Vendimit.

Këshillë juridike:Pala e pakënaqur me Vendimin mund të parashtroj ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit në afat prej dhjetë(10)ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Udhëheqësi i Prokurimit


(Zekë Bardhaj)